



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 134/1 Prot

Tiranë, me 13/02 / 2015

**Lënda:** Jepet mendim mbi Strategjinë Ndërsektoriale dhe Planin e Veprimit për Luftën kundër Korrupsionit 2015-2017

**Drejtuar:** **Z. Bledar ÇUÇI**  
**MINISTËR PËR ÇËSHTJET VENDORE**

Tiranë

I nderuar z.Çuçi,

Në përgjigje të shkresës tuaj Nr.563 Prot, datë 4.2.2015, "Dhënie mendimi për projekt-vendimin për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale dhe Planit të Veprimit për Luftën kundër Korrupsionit 2015-2017" dhe në zbatim të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" si dhe ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, propozojmë si vijon:

Në kuadër të zbatimit të *pikës 1, të objektivit A 1 dhe pikës 3, të objektivit A 2, të Kapitullit 3*, të Strategjisë Ndërsektoriale, të merren masat e përshtatshme të sigurisë teknike dhe organizative në lidhje me mbrojtjen e privatësisë së individëve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale. Realizimi i tyre, kërkon një sistem menaxhimi me komponentë procedural dhe masa sigurie të një niveli të lartë lidhur me përpunimin e të dhënave personale, duke trajtuar edhe rrezikun e cënimit të privatësisë.

*Pika 2 e objektivit B 2 të Strategjisë* kërkon ndryshimin e treguesit të zbatimit në projekt planin e veprimit. Ky ndryshim sjell realizimin e objektivit të strategjisë në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

*Në shkronjën B.2.3 të Projekt/planit kundër Korrupsionit*, në treguesin e zbatimit të shtohet "*Harmonizim legjislacioni*".

Në *shkronjën A.1.6 të Projekt/planit*, afati kohor i përcaktuar të zëvendësohet me “1 maj 2015” (referuar nenit 4, të ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”). Ndërsa, tek treguesit e zbatimit, të shtohet “Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP) raporton në Kuvend për zbatimin e të drejtës për informim dhe për programet e transparencës (referuar pikës 1 të nenit 20 të ligjit Nr. 119/2014).

Gjithashtu në tërësi të dokumenteve, emërtimi “Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale”(KMDP) të zëvendësohet me “Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (KDIMDP).

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**Besnik DERVISHI**

